



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 40, datë 04.02.2021

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E
LARTË, PËR TRE POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË
SHPALLURA ME VENDIMET NR.242, NR.243 DHE NR.244, DATË 09.07.2020, TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, PËR KANDIDATEN ZNJ.SAIDA DOLLANI

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 90 dhe nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “ç”, të nenit 86, në pikën 3, të nenit 97 dhe në nenin 100, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi konstatoi se, bazuar në Vendimin nr.1098/2020 Akti, datë 18.01.2021, të Gjykatës së Lartë, procedura e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre nga katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, pikërisht ato të shpallura me Vendimet e tij nr. 242, nr. 243 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, për kandidaten znj.Saida Dollani, është bërë e pamundur, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr. 242, nr. 243 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj.Saida Dollani.
2. Ky vendim i njoftohet znj.Saida Dollani sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR